



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 58

Prishtinë, më 14.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Salih Salihu, Sergjan Popoviç, Adem Salihaj, Shaip Muja, Murat Hoxha, Haxhi Shala, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.2.2017;
3. Shqyrtimi përfundimtar i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për kompleksin “Adem Jashari” në Prekaz;
6. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.2.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 13.2.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi përfundimtar i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryetarja **Duda Balje**, lidhur me këtë projektligj, sugjeroi që të vendoset në mbledhje plenare për dilemën rreth amendamentit të këtij Komisioni, i cili nuk është përkrahur në Komisionin për Integritet Evropian, ngase siç u tha, shifrat nuk mund të ndryshohen ose duhet të përkrahet direktiva e BE-së, ose amendamenti i Komisionit Funkcional. Komisioni nuk ndryshoi qëndrimin e mëparshëm dhe mbeti që në mbledhje plenare të vendoset për projektligjin, në leximin e dytë, duke pasur parasysh që amendamentet e ish- deputetes Alma Lama, janë shndërruar në amendamente të Komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore

Kryetarja, gjithashtu, sugjeroi që edhe ky projektligj të kalojë në parim, ngase në mbledhjen plenare do të arsyetohet nga Qeveria dhe ministri përkatës. Komisioni miratoi në parim projektligjin, të cilin do ta të përcjellë në leximin e parë.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për kompleksin “Adem Jashari” në Prekaz

Kryetarja, ia rikujtoi Komisionit se ky projektligj është punuar nga grupi punues i këtij Komisioni, të cilin e ka udhëhequr z. **Shaip Muja**, i cili konfirmoi se përkundër faktit që është dërguar në Qeveri për mendim, ajo nuk ka dhënë asgjë me shkrim lidhur me implikimet e këtij ligji, megjithatë mori përsipër të prezantojë ligjin në leximin e parë, në mbledhje plenare.

6. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi se në këtë pikë, Komisioni do të shqyrtojë dy çështje shumë të rëndësishme, ngase kompanitë, palët dhe shoqatat i drejtohen Komisionit vazhdimisht me kërkesa dhe urgjenca të ndryshme, ndaj:

- Për projektligjin e trajtimit të ndërtimeve pa leje, i cili është paraparë që të dërgohet nga Qeveria më 30.1.2017, pasi që ka kërkesa të ndryshme pse nuk vjen në Kuvend, Komisioni zhvilloi debat, ku morën pjesë: **Murat Hoxha, Emilija Rexhepi, Time Kadrijaj, Salih Salihu, Shaip Muja dhe Adem Salihaj**, dhe u konstatua se Qeveria duhet të zbatojë ligjin në fuqi, përkundër faktit se nuk është

dërguar ligji i ri, andaj ajo është përgjegjëse për t'iu dhënë përgjigje kompanive ose palëve, që revoltohen me arsye, për shkak të humbjeve që përjetojnë në mungesë të ligjit apo në mungesë të zgjidhjes së duhur, ngase ligji ekziston, por nuk zgjidh problemin. Në fakt, me këtë humb edhe ekonomia e vendit, ndërsa Kuvendi nuk ka ingerenca të përzihet në këto çështje. **Komisioni vendosi që të ftojë ministrin në mbledhjen e radhës, lidhur me këtë çështje.**

- **Për çështjen e Hades**, fillimisht diskutoi **Adem Salihaj**, i cili njoftoi Komisionin se në takimin e grupit punues, dje është ftuar edhe Avokati i Popullit për bashkëpunim, por mund të thuhet se ka ndodhur një risi, ngase u shfaq dilema se çfarë dëshirojnë banorët e Hades, pasi që dje kanë vendosur për të dalë në protesta, në njërën anë përfaqësuesja e FIQ thotë se heqin dorë edhe nga hartimi i ligjit nga Komisioni, kurse në anën tjetër, banorët insistojnë dhe falënderojnë Komisionin për hartimin e ligjit, për mos të zvarritur çështjen. Meqenëse çështja qëndron kështu, ai ishte i mendimit se momentalisht, grupi punues mund ta lë anash hartimin e ligjit dhe të iniciojë debat në Kuvend, duke propozuar rekomandime, pastaj nëse çështja nuk ecë, grupi punues të vazhdojë me hartimin e ligjit. Ligji për shpronësime, vazhdoi, nuk aktivizohet nëse nuk kemi ndonjë vendim për dislokim të gjysmës së Hades së mbetur, pa u dislokuar. Edhe **Murat Hoxha** ishte i mendimit se ligji për shpronësime nuk zbatohet pa ndonjë vendim paraprak. Sipas tij, edhe po që se përfundon hartimi i ligjit në grupin punues, do të duhej ndonjë vendim paraprak për aktivizimin apo zbatimin e tij, megjithëse pranoi se ligji në fuqi ka mjaft të meta. **Time Kadrijaj** ishte e mendimit se Qeveria nuk shpreh gatishmëri për zgjidhje, përndryshe rrugëzgjidhjet janë evidente. **Shaip Muja** ndërhyri, duke apeluar moskrijimin e një situate të re, ngase formula e çështjes është si vijon : “Unë ju krijoj kushtet për jetesë me një shtëpi në Shkabaj dhe po filloj të paguaj ngadalë për pronën”, pastaj sqaroi se Qeveria nuk ka vullnet dhe as plan për Haden, duke krijuar terme të trilluara “komuniteti minerar” etj. **Time Kadrijaj**, pyeti: Pse nuk ka lobuar mjaftueshëm për këtë çështje? **Adem Salihaj** hapi polemikën rreth çmimit për shtëpitë etj., duke konstatuar se për Haden nevojiten rreth 30 milionë, kurse me tantimën ekzistuese, ajo vështirë realizohet. Pasi që kryesuesja pyeti se a është Komisioni për debat apo për rekomandime, **Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të përgatiten rekomandimet, të cilat pastaj do të dërgohen në mbledhje plenare për vendim meritore për këtë çështje, pas së cilës, nëse nuk do të ketë rezultate, grupi punues do të vazhdojë me hartimin e ligjit.**
- **Nënkryetari Salih Salihu**, inicioi çështjen e vizitës në Shqipëri dhe shkëmbimin e përvojave të përbashkëta me Komisionin homolog në Kuvendin e Shqipërisë, sidomos në nxjerrjen e ligjeve të rëndësishme, ndaj kërkoi nga stafi të kontaktojë me Ambasadën e Shqipërisë, pasi që procedurat fillestare kërkojnë që Komisioni duhet të ketë ftesë zyrtare.

Mbledhja përfundoi në orën 12.20.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje